



REGJISTRIMI NE BIBLIOTEKAT E QYTETIT TE PARISIT

Rrjeti i bibliotekave bashkiake përmbledh bibliotekat ku mund të huazoni libra si dhe bibliotekat e specializuara të hapura për të gjithë. Ju mund të regjistroheni si në bibliotekat e huazimit ashtu edhe në bibliotekat e specializuara duke plotësuar formularin që vijon për tu pajisur me një të dyja kartat e përdoruesit.

Z. Znj **MBIEMRI :** (në gërma kapitale) _____

Emri : _____

Data e lindjes : ____ / ____ / ____ **Seksi :** Mashk. Fem.

Adresa : _____

Kodi postal : _____ **Qyteti :** _____

e-mail : _____ **@** _____

Telefoni fiks : _____ **Telefoni celular :** _____

Profesioni : _____

Nëse regjistrimi bëhet nga një përfaqësues :

MBIEMRI dhe Emri i përfaqësuesit : _____

- Deklaroj mbi nderin tim që banoj në adresën e sipërpërmendur.
- Deklaroj se jam njohur me rregulloren e bibliotekave të Qytetit të Parisit, një kopje e të cilës më është dhënë.
- Dëshiroj të marr me e-mail të gjitha sinjalizimet lidhur me llogarinë time si dhe informacionet lidhur me veprimtarinë e bibliotekës (info-letër) : Po Jo
- Dëshiroj të marr hua :

- materiale falas (libra, libra zanorë, revista, partitura, metoda për mësimin e gjuhës...)

- kompakt disqe (CD) seksioni për të rritur. Rregjistrimi vjetor 30,50€

- filma (DVD) dhe CD seksioni për të rritur. Rregjistrimi vjetor 61€

Për minorenët

Shiko informacionet në faqen mbrapa

Vërtetimi në vijim duhet të plotësohet nga përgjegjësi ligjor.

Unë i/(e) nënshkruari(a) _____ duke vepruar në cilësinë e _____ të fëmijës, autorizoj regjistrimin e tij për të marrë hua materialet e shënuara me kryq.

Për personat që përfitojnë nga Exception Handicap : Kur regjistrohem për herë të parë, sjell një certifikatë që më lejon të tërheq në Polin Shurdhët dhe Leximi ndryshe dhe pa pagesë materiale të përshtatura, CD dhe DVD.

Je désire m'inscrire dans les bibliothèques spécialisées (inscriptions uniquement dans les

Data : ____ / ____ / ____ **Firma :** _____

Asnjë pagesë nuk bëhet në momentin e regjistrimit.

Fatura e pagesës së regjistrimit ju dërgohet nga Thesari publik.

A remplir par le bibliothécaire

Bibliothèque d'inscription : _____

N° d'inscription : _____

N° SOI (agent de la Ville de Paris) : _____

Autre cas d'exonération : _____

Drejtoria e Kulturës

Zyra e bibliotekave dhe e leximit

Vërejtje për prindërit dhe tutorët legalë të fëmijëve

Vend leximi për tu argëtuar apo për punë, biblioteka është e hapur për të gjithë dhe pranon fëmijë dhe adoleshentë, vetëm ose të shoqëruar. Minorenët janë nën përgjegjësinë ligjore të prindërve të tyre: ju këshillojmë që t'i shoqëroni gjithmonë fëmijët në moshë të vogël për arsye se hyrjet dhe daljet nga biblioteka nuk mbikqyren.

Punonjësit e bibliotekës nuk mbajnë përgjegjësi përsa i përket librave që zgjedh fëmija. Sipas rregullores, disa video nuk u jepen fëmijëve nën moshën 12 vjeç, nën 16 vjeç apo në moshën 18 vjeç. Minorenët nën moshën 7 vjeç kanë të drejtë të tërheqin vetëm materiale "për fëmijë". Nga mosha 7 vjeç deri në moshën 12 vjeç, fëmijët mund të tërheqin materiale për të rritur vetëm me pëlqimin e prindërve.

Mbi moshën 12 vjeç, minorenët kanë të drejtë të tërheqin libra për të rritur, por prindërit mund të japin shprehimisht një deklaratë të kundërt me shkrim.

Informacione të përgjithshme

Hyrja në të gjitha bibliotekat dhe mediatekat e qytetit të Parisit është e mundur për të gjithë.

Marrja hua apo leximi i materialeve është i mundur pas regjistrimit dhe pajisjes me një librezë antarësie. Për tu regjistruar, antari i bibliotekës duhet të jetë i pranishëm dhe i pajisur me një dokument identiteti. Në rast të kundërt, ai mund t'i bëjë një prokurë personit që dëshiron, i cili duhet të provojë identitetin e tij si dhe atë të përfaqësuesit. Çdo deklaratë e rreme ndëshkohet penalisht sipas neneve 433-19, 441-7, 313-1 dhe 313-3 të Kodit Penal.

Libreza blu e antarit ju lejon të tërhiqni materiale në të gjitha bibliotekat dhe mediatekat bashkiake të huazimit.

Në bibliotekat e specializuara (libreza e verdhë), vendet e leximit u jepen në përparësi antarëve të regjistruar që lexojnë materialet e bibliotekës.

Titullari i librezës mban përgjegjësi për përdorimin që i bën librezës, madje dhe në rast se e humb apo ia vjedhin atë. Është në interesin e tij që të lajmërojë menjëherë bibliotekën në rast se humb apo i vjedhin librezën.

Përdoruesit mbajnë përgjegjësi për materialet që kanë marrë hua. Ata e kanë për detyrë t'i sinjalizojnë punonjësve të bibliotekës çdo dëmtim që kanë vënë re në momentin e marrjes hua. Asnjë riparim nuk duhet bërë nga përdoruesit vetë.

Çdo material i humbur ose që kthehet në një gjendje që nuk mund të jepet hua sërisht (i nënvizuar, i ngjyrosur, i njollosur, i grisur, i lagur) duhet rimbursuar me të njëjtën vlerë me çmimin publik të librit ditën e rimbursimit. Në rast se materiali nuk gjendet më në treg, do të paguani vlerën e zëvendësimit. Dëmshpërblimi i një materiali ju çliron nga ndonjë gjobë e mundshme për vonesën në kthimin e tij.

Rregullorja e plotë është shpallur në bibliotekë. Punonjësit e bibliotekës janë në dispozicionin tuaj për çdo informacion shtesë.

Afati i marrjes hua

- 21 ditë, afati mund të zgjatet dy herë aty në vend ose nëpërmjet internetit, nëpërmjet llogarisë së përdoruesit, [përpara skadimit të afatit të marrjes hua](#).
- Në rast vonese, aplikohet një gjobë : 0,15€ për çdo material dhe për çdo ditë vonesë, 0,07€ për minorenët.

Gjobat duhen paguar nga momenti që shuma tejkalon 15 €.